

PËRMBLEDHJE

SUBJEKTI I MONITORUAR, ZNJ. EGLANTINA MIKANI, GJYQTARE, GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KORÇË



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINK

Raportim paraprak i seancës dëgjimore të datësë 25/10/2022 realizuar pranë KPK

- ✓ Kriteri i pasurisë: U kërkuan shpjegime shtesë për disa prej pasurive të paluajtshëm dhe të luajtshme të rivlerësuara
- ✓ Vlerësimi i aftësive profesionale
Raport pozitiv nga KLGJ, por 6 ankesa pranë ish-KLD Për një prej këtyre ankesave janë pretenduar shkelje procedurale në kundërtim me nenin 202 të KPrC.
- ✓ Pranë KPK janë depozituar 10 denoncime, të cilat nuk u shqyrtuan gjatë seancës, por u pohua nga ana e relatores që për 6 prej tyre i është kërkuar subjektit të ofrojë shpjegimet e saj.

VETTING

VETTING

VETTING

VETTING

VETTING

NJOFTIM I PËRMBLEDHUR

Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Znj. Eglantina Mikani, përballet me rivlerësimin e saj në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK)

Më 25 tetor 2022, në KPK, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit znj. Eglantina Mikani, Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për shkak të funksionit si gjyqtar, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim ligji nr. 84/2016). Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej pa praninë e një mbrojtësi ligjor. Trupi gjykues përbëhej nga Roland Ilia (Kryesues), Pamela Qirko (Relatore) dhe Brunilda Bektashi (Anëtare). Si vëzhgues ndërkombëtar ishte i pranishëm z. Francesco Ciardi, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Në këndvështrimin e mbajtur nga KPK në seancën dëgjimore, raporti i hartuar nga ILDKPKI mbi kriterin e pasurisë nëpërmjet të cilit evidentohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur pasurinë dhe nuk reflekton të jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesave, nuk rezultoi i saktë. Sipas KPK, dokumentacioni bashkëlidhur këtij raporti, mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është jo i plotë.

Nga të dhënat rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka trashëguar nga babai i saj truall + ndërtesë (1/3 e saj pjesë takuese) në Korçë dhe truall 103m² (1/2 e saj pjesë takuese). Subjekti posedon depozitë bankare të përbashkët me bashkëshortin, para cash, autoveturë. Sipas relatores krijimi i depozitës bankare në vitet 2006-2011 (nga subjekti dhe bashkëshorti i saj), sa i përket përlllogaritjeve në raport me burimet e krijimit rezultoi në pamjaftueshmëri financiare për shumën 1.1 milion lekë. Ky konstatim u sqarua nga ana e subjektit gjatë kësaj seance dëgjimore.

Lidhur me kontrollin e figurës, përse i përket raporteve të hartuara nga DSIK, fillimisht raporti i parë ka rezultuar pozitiv në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016. Por në qershor të vitit 2022 janë ngritur dyshime se subjekti ka shpërdoruar detyrën, duke favorizuar një shtetas të proceduar penalisht gjatë caktimit të masës së sigurisë. DSIK ka konstatuar shkeljen, por nuk ka përcjellë një raport të dytë. Nga hetimi i ndërmarrë nga KPK kanë rezultuar disa indicie në kriterin profesional lidhur me nevojën e caktimit të një mase sigurie. Kjo bazuar në nenin 71 e në vijim të ligjit 96/2016.

Raporti nga KLGJ ka rezultuar pozitiv për subjektin e rivlerësimit, sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale. Ndërkohë, nga verifikimi të dhënave arkivore është konstatuar se ndaj saj janë depozituar 6 ankesa pranë ish-KLD. Për një prej këtyre ankesave janë pretenduar shkelje procedurale në kundërtim me nenin 202 të KPrC. Ish- KLD ka kërkuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares, por pretendohet se Ministri i Drejtësisë në atë kohë nuk ka vepruar.

Ndaj subjektit të rivlerësimit pranë KPK janë depozituar 10 denoncime, të cilat nuk u shqyrtuan gjatë seancës, por u pohua nga ana e relatores që për 4 prej tyre i është kërkuar subjektit të ofrojë shpjegimet e saj.

Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit znj. Eglantina Mikani kërkoi konfirmimin në detyrë, ndërsa KPK shtyu seancën për shpalljen e vendimit më 26 tetor, në orën 13:00.